

SKEMA E GRANTEVE PËR ANËTARËSIM NË RRJETE RAJONALE/NDËRKOMBËTARE

UDHËZUES PËR APLIKIM

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), me qëllim të fuqizimit të rolit të shoqërisë civile në hartim dhe zbatim të politikave, të cilat prekin komunitetin dhe publikun e gjerë përmes nxitjes së veprimeve të përbashkëta me partnerët, ofron përkrahje financiare për anëtarësim të OJQ-ve në rrjete rajonale/ndërkombëtare.

KUSH MUND TË APLIKOJË: Organizatat joqeveritare të regjistruara në Kosovë.

KRITERET E PËRZGJEDHJES:

Të gjitha aplikimet do të shqyrtohen individualisht dhe do të vlerësohen nga komisioni, bazuar në këto kritere:

- Përfitimet që do të ketë organizata, shoqëria civile dhe vendi nga ky anëtarësim.
- Përputhshmëria e misionit, fushëveprimtarisë së organizatës aplikuese me misionin, fushëveprimtarinë e rrjetit në të cilin kërkohet anëtarësimi.

Përparësi do të kenë organizatat që nuk mund të mbulojnë pagesën e anëtarësisë nga ndonjë burim tjetër.

ÇKA FINANCOHET?

Pagesa e anëtarësisë (membership fee).

Shpenzimet e transferit bankar.

NUMRI I APLIKIMEVE DHE GRANTEVE PËR APLIKANTË:

Aplikantët mund të aplikojnë me më shumë se një aplikacion.

Aplikantët mund të jenë përfitues të grantit për rrjetëzim një herë brenda vitit.

KOHËZGJATJA:

Pagesa e anëtarësive do të jetë për periudhë më së shumti 1 vjeçare.

Nuk bëhet rimbursim i anëtarësive të paguara paraprakisht. .

PËRKRAHJA:

Shuma maksimale e përkrahjes është **800 euro për anëtarësi** (duke mos i përfshirë shpenzimet e transferit bankar).

DOKUMENTET PËR APLIKIM:

Aplikuesit duhet të dorëzojnë dokumentet në vijim:

Përkrahur nga:

- Formën e aplikimit;
- Një kopje të certifikatës së regjistrimit të OJQ-së të lëshuar nga MAP;
- Çfarëdo dokumenti që dëshmon anëtarësinë, nëse aplikohet, për vazhdim të anëtarësisë ekzistuese (pagesën e anëtarësisë paraprake, faturë, email, etj);
- Çfarëdo dokumenti që dëshmon gatishmërinë e rrjetit për praninë të organizatës, në rastet kur aplikohet për anëtarësi të re (faturë, email, zotim, etj).

KU DHE SI TË DORËZOHEN APLIKACIONET:

Aplikacionet duhet të dorëzohen në formë elektronike.

Aplikacioni i kompletuar duhet të dërgohet në formë elektronike në e-mailin kcsfsida@kcsfoundation.org me titull në subjekt të e-mailit ***“Aplikacion për grant për rrjetëzim - Emri i plotë i aplikantit”***

Në e-mail duhet të jenë të bashkëngjitura të gjitha dokumentet për aplikim. Aplikacionet e pakompletuara nuk do të vlerësohen.

AFATI I FUNDIT PËR APLIKIM:

Aplikimi për grante për rrjetëzim do të jetë i hapur deri në shpenzim të fondeve. Aplikuesit do të njoftohen rreth vendimit të komisionit më së voni 30 ditë nga data e aplikimit.

Të gjitha pyetjet lidhur me aplikimin për grante nga kjo skemë mund të dërgohen në e-mailin kcsfsida@kcsfoundation.org

Përkrahur nga: